



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008 dhe nenit 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2017, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, e miratojë këtë:

#### VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT NË LIPJAN PËR RIVENDOSJEN E SHTATORES-BUSTIT TË VEPRIMTARIT TË LËVIZJES KOMBËTARE MULLA HAMIT SLOVISË

##### Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni me sipërfaqe prej 10m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale P-71409044-01307-13 në vendin e quajtur "Qeramidica" zona kadastrale Lipjan P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan e evidentuar në Certifikatën Nr.5/2017, për rivendosjen e shtatores-bustit të veprimtarit të lëvizjes kombëtare Mulla Hamit Slllovisë.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

##### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

##### Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Aktvendimi i Kryetarit të Komunës 1Nr.464-266 i datës 14.05.2010 për dhënien në shfrytëzim të pjesës së parcelës kadastrale nr.1591 ZK Lipjan me sipërfaqe prej 10m<sup>2</sup>, për vendosjen e shtatores-bustit të Mulla Hamit Slllovisë.

15Nr. 463-4284  
Lipjan më 01.02.2017

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesja e Kuvendit  
Vlora Limani-Hajnuni

